

VENDIM
Nr. 135, datë 20.9.2012

**MBI ANKIMIN ADMINISTRATIV TË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA NË LIDHJE ME
VENDIMIN NR. 128, DATË 11.9.2012 “PËR PROCEDIMIN ADMINISTRATIV PËR VENDOSJE
GJOBE NDAJ SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA” TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË
ERE-S**

Në mbështetje të nenit 9 pikat 1, 4 dhe nenit 64, pika 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 pika 1 të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenit 25 pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.9.2012, pasi analizoi ankimin e paraqitur nga “CEZ Shpërndarje” sh.a. me shkresën nr. 5463/1, datë 18.9.2012, si dhe relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

konstatoi se:

- Ligji nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 64 pika 4 përcakton se “Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimit dhe ekzekutimi i vendimeve të Bordit bëhet sipas ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

- Ligji nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” në nenin 26 të tij përcakton se “Kundër vendimit për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënim me gjobë, të nxjerrë nga organi i administratës, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit”.

- Kodi i Procedurës Civile në nenin 328 të tij përcakton se “Afati për paraqitjen e padisë ndaj një akti administrativ është tridhjetë ditë nga dita e shpalljes ose e njoftimit të vendimit të organit më të lartë administrativ, që ka shqyrtuar ankesën në rrugë administrative, përveç kur ligji parashikon ankimin e drejtpërdrejtë në gjykatë. Në këtë rast, afati fillon nga dita e shpalljes ose e njoftimit të aktit administrativ ndaj të cilit është paraqitur padia”.

- Neni 25 i Kodit të Procedurave Administrative përcakton detyrimin e organeve administrative për të verifikuar, nëse kanë ose jo, juridiksionin për të vendosur mbi një çështje.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Deklarimin e mungesës së juridiksionit të ERE-s për ankimin e “CEZ Shpërndarje” “Mbi vendimin nr. 128, datë 11.9.2012 “Për procedimin administrativ për vendosje gjobe ndaj shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.”;

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani